



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1328 Prot

Maliq, më 01.03.2024

VENDIM

Nr. 15, datë 01.03.2024

“Për miratimin e proces verbalit të datës 31.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Maliq”


Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 53 pika 8, neni 54 gërma “k” si dhe neni 88, i Rregullores të funksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 31.01.2024 bashkangjitur.
2. Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMETIARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 31.01.2024

Prot.15 (pesëmdhjetë)

Protokoll nr. 15

I mbajtur sot më datë 31.01.2024, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi,miratimi i rendit të ditës,vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
- 3.P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2023”;
- 4.P-V “Për shlyerje detyrimi për ekspert-psikolog vendosur nga gjykata e rrethit gjyqësor Korçë mbi rastin e fëmijës F.Myrtollari”;
- 5.P-V “Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për familjet në nevojë, që do të trjatohen në Ndhmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2024”;
- 6.P-V“Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit, për vitin 2024”;
- 7.P-V “Për miratimin e Planit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027”;
- 8.P-V “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për peiudhën 2023-2025”;
- 9.P-V “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2024”;
- 10.P-V“Për miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike, Rregulloren dhe menyrën e funksionimit të këshillit vendor për sigurinë publike”;
- 11.P-V “Për mbajtjen e zgjedhjeve në Drtihas poshtë, Njësia Administrative Libonik”;
12. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Eriseld Jonusllari;Pranvera Begolli;Gentiana Drabo; Aramando Dautllari; Marianthi Avrami; Danjela Ibrahim; Plator Çollaku; Klea Baçi; Rovena Terolli; Fevri Sherifi; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Ildir Limllari;Dalina Krekas; Ilia Xhuti; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Albina Xhejo; Eglantina Balli; Neresida Shindo; Lulëzim Hoxhaj; Almir Elezi. 28 (njëzetëtetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu;Drejtoe e Financës dhe Buxhetit:Almira Muka; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermanda Petriti;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të bashkisë Maliq, me rendin e ditës dhe materialet besoj se ju jeni njohur parprakisht, verifikojmë kurimin nëpërmjet apelit, pastaj vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, Enida Avdulli mungon me arsye, Dritan Çami mungon me arsye, Server Xhuti mungon me arsye, korumi realizohet jemi 28 Këshilltarë në sale, vazhdojmë me rendin e ditës, vijomë me mbledhjen e dhe rendin e ditës, miratojmë rendin e ditës?

Faslli Zholi: Të nderuar Këshilltarë, i nderuar Kreytar i këshilli, i nderuar Kryetar i Bashkisë, para se të futemi te rendi i ditës, dua të shpreh indinjatën pse rendin e ditës nuk e kemi shqyrtuar në kryesi! Sepse këtë e lejon dhe Rregullorja e Këshillit, ne nuk kishin djeni dhe ne kishim disa çështje për të shtuar në rend dite. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Ke shumë të drejtë, këtë e përcakton dhe Rregullorja, që rendi i ditës përcaktohet me dakortësinë e Kryesisë, këtë mbledhje nuk e realizuam, por ne nuk e dinim nëse ju e kisht thyer bojkotin dhe a do ishit sot në mbledhje, megjithëatë kenë shumë të drejtë, nga tani e në vijim do vazhdojmë si më parë.

Faslli Zholi: Faleminderit! Si do që të jetë, ju duhet ta konsultoni dhe do japim sygjerimit tona.

Ornildi Demollari: Me Kryesinë është konsultuar, por me grupin tjetër dhe ka patur dakortësi për rendin e ditës.

Petrit Kupe: Duke miratuar rendin e ditës, doja të propozoja një ndryshim në renditje, pika e parë të jetë P-V Miratimi i buxhetit shtesë.

Pranvera Begolli: Kam edhe unë diçka Kryetar, te pika 11 ku kemi të bëjmë me zgjedhjet për kryetarin e fshatit Drithas, do doja meqënëse Komisioni i Ligjeve dhe Rregullores në datë 16.01.2024 u mbledh, do doja të jepja thjesht një sqarim se çfarë ndodhi në mbledhje.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim rendin e ditës? Me këto propozime?

Kush është dakord ? 28 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 28 vota pro rendi i ditës, me këto ndryshime. Më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kalur, janë gjithësej 10 vendime me karakter normativ të cilat kanë marrë dakortësinë e Institucionit të Prefekturës dhe 6 vendime me karakter individual ose kolektiv që nuk kanë nevojë të shkojnë në Prefekturë. Ju ftoj të miratojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, procevarabli i zbardhur nga Sekretari ose Sekretariati, nuk është procevarabli i fjalëve të dhëna në mbledhjen e kaluar, ftoj kolegët të miratojmë një Komision sipas Rregullores të miratuar nga ana juaj në datë 12.03.2020 me vendim 24, për verifikimin e proceverabalit, është hequr fjala e z.Andonaq Risto për sa i përket problematikës të fshatit Zvezdë dhe fjala e znj.Rudina Bregu e cila thotë që në zgjedhjet e fshatit Zvezdë ishte dhe z.Serever Xhuti.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim proceverbalin e mbledhjes?


Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes? 28 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 28 vota proceverbali.Faliminderit! Tani sipas dakortësisë që bëme pika 3 është, P-V "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2024"; Kryetar ke fjalën.

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu: Përshëndetje! Të nderuar Këshilltarë, materiali që ju kemi paraqitur është Projekt-Buxheti shtesë që pas rrakordrimeve që bëjmë me degën e Thesarit Korçë për fonde të mbartuara nga buxheti i vitit 2023 po ja u paraqesim, totali i buxhetit shtesë është 62 milion 051.747 lekë, të ndara në transferta (grand) që janë fonde të kursyera nga buxheti i bashkisë për transfertën e pakushtëzuar, transferta specifike që janë për pozicionet specifike që mbulon bashkia, si Shërbimi Zjarrfikës, Ujitje Kullim etj, Pyje Kullota, Arsim etj, në total kapin një vlerë 28 milion 489.497 lekë, të ardhura nga buxheti i pavaur të mbyllura në fund të vitit 12 milion 698.049 lekë dhe mbartuara kap.6 70.514 lekë, transferta specifike edhe në relacion ja u kemi shpjeguar kapin vlera të konsiderueshme edhe për ato fatura të prapambetura që kanë mbetur në fund të vitit pa lilljuar, që janë detyrim i parë për vitin 2024 dhe kemi një shtesë fondesh për vitin 2024 të cilat përfshihen në pasqyrën që ju keni bashkangjitur. Në totalin e përgjithshëm shpenzime për investime në buxhetin shtesë kemi futur dy zëra, një zë ka të bëjë me hartimin e një plani strategjik të bashkisë Maliq, i cili kap vlerën 6 milion lekë dhe një fond për bashkëfinancim proktesh, kap vlerën 8.282 milion lekë dhe një fond për pajisje teknike për Shërbimin Zjarrfikës dhe Shërbimin Publik, njëra 175.000 lekë dhe 120.000 lekë të cilat, janë menduar të mbulojnë disa shërbime ekestra të këtyre dy strukturave. Transferta specifike për arsimin kap vlerën 1.617.551 lekë, Ujitje-Kullim 12 milion 915.496 lekë, për Mbrojtjen nga zjarri 1.760.389 lekë, Rrugët 255.289 lekë dhe Pyje-Kullota 21.925 lekë. Dua ti sjell në vëmendje Këshilltarve që të gjitha fondet specifike që janë kursyer në buxhetin e bashkisë nuk mund të çohen në zëra të tjerë, por mbahen përsëri në struktura të përcaktuara, pasqyra që ju kemi shoqëruar në mënyrë rigoroze për këtë detyrim ligjor që kemi, fatura të prapambetura të vitit 2023 kapin vlerën 373.344 lekë, shpenzime operative shtesë për vitin 2024 ju propozjmë dy 694.555 lekë sipas tabalës bashkangjitur, fatura në invtesime të prapambetura 2023 në investime kapin shumën 19.610.484 lekë, në takimin që patëm me Komisionin e Financës pati një propozim për të rritur fondin Social me 500.000 lekë, mu duk i arsyeshëm si propozim, këtë fond e përdorim për familje në nevojë dhe raste të veçanta, po kjo kërkon përsëri vendimin e përndryshim në fondin e bashkëfinancimit, nga 8.2 milion 8.280 lekë të ulet me 500.000 lekë, duke bërë një rialokim fondi, do jem shumë dakord që ta shtojmë këtë fond në buxhetin bazë. Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

që e kërkojmë. Tek shëndetësia thuhet, se specialistë të fushave të caktuara janë njëherë në javë të gatshëm për vizita, kur? Thuhet se Qendra Shëndtësore zhvillon fushata ndërgjegjësimi në shkolla, të vendosen kamara dhe një roje nate për Qendrat Shëndtësore, por të shtohet dhe një Mjek roje natën. Te bashkëpunimi Shërbimi Social është për tu lavdëruar, i vlersoj për punën. Te sturktura e Shërbimit Social, bëj një propozim, aktualisht në qytetin e Maliqit nuk ka ndonjë specialist për fizioterapi, ne kemi një vjazë që ushtron fizioterapi te Qendra, a mund ta përdorim për të bërë fizioterapi te qytetarët? Me një pagesë. Bizneset e qytetit janë të intresuar të na ndihmojnë? Këto kisha.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Plani i Mbrojtjes Sociale standart, i hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe i përshtatur me kushtet e bashkisë Maliq. Pranvera ngrit disa probleme apo mendime dhe unë mendoj që Plani në vetëvete duhet zhvilluar apo shtjelluar dhe për rregullimin e ndonjë lapsusi të vogël, por ajo që unë mendoj është që ne me këto Plane, thithim fonde, fitojmë projekte pasi jo vetëm që e kemi detyrim ligjor, por Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, nuk e fiton dot një projekt, si ai që kemi dy vjet që e fitojmë dhe të shpresojmë të fitojmë dhe atë projekt që Dr. Yllsoni propozoj për PAK që është shumë e rëndësishme vërtet. Me rrakordimet që duhet të bëjmë me Komisionet të kemi propozime konkrete do ishte shumë e rëndësishme, të shpresojmë që jo vetëm Plani i Mbrojtjes Sociale që po kalojmë, mund të ketë nevojë për ndonjë rregullim, nuk besoj se do jetë problem të ketë dhe përfaqësues nga Këshilli, do e kishte vendosur Ministria, e ka për të arsyeshme që duhet të ketë përfaqësues që merren çdo ditë me njerëz të cilët kanë të bëjnë me këto fusha, nëse ju e shihni të arsyeshme nuk është problem i shtojmë dhe dy Këshilltarë, që mund të jenë specialistë që mund ti vijnë në ndihmë këtij Plani. Pse nuk bëhet Thertore? Sepse duhen fonde, i kemi bërë propozimet, të shpresojmë të ndodhë sa më parë, por dhe kjo Thertore që të bëhet duhet të plotësojë disa kushte, dhe një kuotë therje në ditë, që të mbulohen kostot. Për mjeksinë, patjetër që ka nevojë dhe për Mjek rroje dhe shtimin e specialisteve të mirëfilltë, këta nuk varen nga Bashkia, por Këshilli ka të drejtë ta thrasë në raport Drejtorin Rajonal nga ku varet Shëndtësia e Maliqit apo Drejtorin të Qendrave Shëndetësore në një takim për të marrë informacion apo propozime konkrete, Këshilli mund të çojë propozime Ministrinë e Shëndetësisë, e keni këtë të drejtë. Nuk dua të hyjë pjesën e fizioterapisë, e kemi bërë për ata fëmijë, ne sot ja sigurojmë dhe transportin dhe kjo është një nga gjërat më të mira që kemi bërë si Institucion dhe si Këshill për këta fëmijë. Shumë falimindertit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Po Plator.

Plator Çollaku: Duke parë metodologjinë e hartuar të Planit të Mbrojtjes Sociale, është përmendur një organizatë, por këtu ka edhe oragnziata të tjera që merren me fëmijët dhe është shumë e rëndësishme të përmendet si fakt sepse harxhojnë milona lekë për fëmijët, nëse bashkia nuk i ka evidentuar këto, duhet ta bëjë. Të shtohen në material.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Faslli Zholi:Për sa i përket mjeksisë, e kam dhe si pyetje dhe mendim, mund ti sigurohet një ambjent Doktorit që kemi këtu si specialist për ortopedinë, për vizita?

Yllson Ibrahimllari:Ambjentin e kam siguruar vetë dhe sa herë të kem mbledhje Këshilli do bëj vizita falas për të gjithë komunitetin, kjo çështje nuk zgjidhet kështu, zgjidhet me Kryetarin e bashkisë dhe atë të Këshillit.Ne kemi një ndarje gjeografike shumë të mirë për këtë punë, për sa i përket Maliqit, ka mjekë elitar në Korçë në Pogradec që kanë dalë në pension, që një mjek si Vangjush Kostandini, personalitet i eneve të gjakut, me autobuz nga Korça në Maliq nuk ka kosto dhe ai vjen këtu për vizita me kohë të pjesëshme, kështu mund të kemi disa specialistë bazë, ky do jetë propozimi im te Komisioni i Shëndetësisë, unë nuk kam kërkuar atë Komision, por ju mund të ma kishit dhënë ta dretjoja dhe me konsensusin e Kryetares.Unë e kam e ambjentin këtu, nuk po kërkoj nga bashkia do i ralizoj kur ti kem mundësitë që të bëhet një kabinet i përshtatshëm.Faliminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 28 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 28 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2023-2025”;

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Ky është një detyrim ligjor, që duhet ta kalojmë, nuk ka asnjë vendimarrje që është ekzekutive të themi, por është një përmbushje ligjore, që kërkon vendimarrjen e Këshillit, ne bëjmë një planfikim afatgjatë, sipas edhe tavaneve të vendosur nga qeveria dhe Ministrinë përkatëse, kërkohet vendim i Këshillit për këtë qëllim.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Ka ndonjë koment? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 28 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 28 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V“Për miratimin e krijimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike, Rregulloren dhe menyrën e funksionimit të këshillit vendor për sigurinë publike”; Kalojmë në votim? Apo ka dikush diçka?

Kush është dakord ? 28 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 28 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 11 e rendit të ditës, P-V “Për mbajtjen e zgjedhjeve në Drithas poshtë, Njësia Administrative Libonik”;

Pranvera Begolli:Mund të them diçka para se të kalojmë te P-V?Në datën 16 janar u mbledh Komisioni i Ligjeve dhe Rregullores, për problematikën e zgjedhjes së Kryetarit të fshatit Zvezdë dhe Drithas.Sot për Drithasin kemi një P-V për ta votuar, për fshatin Zvezdë duke parë dokumnetacionin dy anëtarë të Komisionin ishin të quheshin të rregullta zgjedhjet dhe tre jo, ne nuk marrim vendim, thjesht japim opinione.Në mbledhjen e parë të këshillit është lexuar raporti i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

përgatitur nga grupi i PS dhe grupi i Opozitës kërkon të lexojë raportin e tyre dhe do doja që Këshilli i bashkisë të merrte një vendim për zgjedhjet në Zvezdë. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Meqëse jemi te kjo pikë, dua ta njoh Këshillin dhe me një ankesë që ka ardhur nga z. Mersin Çoçka që ka ardhur dje nga Prefketa, ku ai pretendon që në proces nuk janë plotësuar kriteret që duhet të kenë kandidatët për kryetar fshati, thjesht dua tju informoj, nuk i është përmbajtur kriteret të arsimit kandidati që fitoj.

Yllson Ibrahimllari: Zotëria ka bërë dhe një kërkesë padi në Gjykatë Administrative për ne si Këshill, është siguruar aksidentalisht sepse kam avokat të përbashkët me z. Çoçka për qëllime të ndryshme, por ka vend që duhet të kem dhe mirëkuptimin e Kryetarit për diskutim dhe jo aprovim, unë ju kam dërguar nëpërmjet e-mail një qëndrim tonin, që ju nuk e keni lexuar dhe shumë mirë keni bërë se ja u ka dërguar unë, ju kam dërguar një material në datën 26, është lexuar materiali i znj. Rudina, nëse Këshilltarët duan të njihen, sespe materiali ka shkuar në të gjitha adresat e e-mail, besoj se e kanë të qartë dhe nuk është i nevojshëm leximi nga ana ime, por nëse shkojmë për procedurë, do shkojmë kështu, znj. Pranvera do lexojë në emër të Komisionit se çfarë kanë menduar ata, ose do lexoj unë paraprakisht dhe ata do mbajnë një qëndrim dhe mbi fjalën e dy grupeve dhe do konsultohemi gjithnjë me rregulloren, nëse kemi shkelur rregulloren e të z. Çoçka e të tjerë të merret vendim nëse kemi shkelur rregulloren, por ndodhemi para një fakti Gjykata Administrative do shprehet pro a kundra, nëse do e futim Këshillin që për çdo ankesë të dalë, të gjitha praktikat e ndjekura mund të jenë me çedime nga rregullorja, o do i futemi ta shqyrtojmë në themel të gjithë procesin ose do kemi ato që kemi aprovuar ti lemë këtu dhe ti përmirësojmë dhe të zbatojmë rregulloren për Drithasin dhe të zbatojmë rregulloren për Zvezdën ose secili shkon në rrugë vetë dhe shkojmë në Gjykatë e zgjidhim atje. Ju faleminderit!

Lulëzim Hoxhaj: Në lidhje me këtë problem që është diskutuar disa herë, unë ka një mendim pak të çuditshëm, ju kërkoj të më dëgjoni deri në fund. Unë nuk propozoj për Zvezdë dhe Drithas të ribëhen zgjedhjet, unë propozoj që në të gjithë fshatrat të ribëhen zgjedhjet. Në rast se do i referohemi fakteve, procedurat e ndjekura në të gjitha fshatrat janë shkelje. Së pari, janë shkelur të gjitha kriteret e vendosura nga Komisioni, kush e ka drejtuar këtë proces. Po të marrim arsimin është një kriter dhe nuk është vendosur kot, duhet Kryetari i Fshatit duhet të plotësojë arsimin e mesëm ose të barasvlefshëm, kjo e përcaktuar në rregullore.

Ornildi Demollari: Në rastin kur nuk përmbushet ky kriter, ta lemë pa kryetar fshatin?

Lulëzim Hoxhaj: Në këtë rast, në fshatin Çaušli është zgjedhur një kandidat me 4 klasë, përballë kishte një Juridik. Ditën e parë që kam ardhur në Këshilli, isha të qëndronim larg bindjeve politike. Për mendimin tim Kryetarët e fshatit janë bazë e administrimit të fshatit, ne duhet të kemi paryesh Kryetarin e Këshillit të fshatit ka qenë personaliteti më i rëndësishëm i fshatit dhe janë shkelur jo vetëm arsimi, por edhe nuk mund të zgjidhen dhe ma atë risinë që na i solli Rudina në çdo shtëpi në Zvezdë. Dashnor Shahinasi me këtë llogjikë duhet të jetë Kryetar i fshatit Drithas poshtë sepse unë kam 150 firma nga banorët që e kërkojnë të Kryetar i fshatit. Kryetarin nuk e zgjedhin votat, por sipas rregullores e zgjedh Kryesia, Kryesia zgjidhet nga banorët. Nuk mund të bëhet votimi në rast se nuk sigurohen më shumë se gjysma e banorve me të drejtë vote, nëse duam të zbatojmë rregullat. Procedura e zgjedhjeve, është një procedurë e gabuar që sjell një produkt të gabuar, në asnjë rast nuk është ndjekur procedura, le të dali kush të dojë nga Sekretari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

i Këshillit dhe ju me radhë dhe të thotë që procedura është bërë në rregull, nuk mund të bëhet votimi në rast se nuk sigurohen më shumë se gjysma e banorve me të drejtë vote, nuk mund të shpikim votimi, si në rastin ku voton një pjestar për familje, çdo kush ka të drejtë të votojë. Kryetari i Këshillin nuk mund të jetë më shumë se dy mandate është e përcaktuar në rregullore, ne kemi Kryetar fshati me tre ose katër mandate, fashti nuk ka dikë tjetër të aftë ta bëjë këtë punë! Unë mendoj që Drithasin dhe Zvezdën në të gjitha rastet ne kemi shkelje, ta jap me përgjegjësi se mbi 50% e Kryetarve të fshatit janë me arsim të ulët, spese ne nuk e kemi të qartë akoma konceptin e Kryetarit të fshatit, prandaj e bëra dha atë propozim që të shtohet fondi për ti vlersuar këta si kapacitete, si njerës që do e drejtojnë komunitetin, prandaj them që këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Drithasi dhe Zvezda, sepse ju e kaluat me fjalën Gjilpërë në Kashtë, e kam me ju Kryetar, nuk është kështu, ka të bëjë me parimin bazë dhe ky parim që e ka dhe Kushtetuta, është që që zgjedhjet të jenë sa më demokratike, sa më reale dhe sa më të vërteta. Unë kam ngritur dorën dhe kam pranuar listën, por morra shkas nga kandidati i Drithasit që ishte kandidati jonë, kam një pyetje për ty Kryetar, çfarë keni kërkuar te Ministria e Brendshme?

Ornildi Demollari: Drithasi poshtë nuk është fshat dhe ti e di këtë.

Lulëzim Hoxhaj: Me rregullore thuhet që mund të bëhen dy lagje, këto rregullohen me VKB, duke ditur këtë pse pranuat të bënit zgjedhje në Drithas lart?

Ornildi Demollari: Sepse është fshat.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Të ndërhyj pak, sepse po filluam të gjithë të diskutojmë dhe secili mund të ketë të drejtë në pjesën e tij. Nuk e kuptova atë fjalën Gjilpërë në Kashtë?

Lulëzim Hoxhaj: Ka të bëjë me atë që ke thënë para dy mbledhjeve, ku unë nuk kam qenë prezent, kur është ngritur çështja e Drithasit dhe e Zvezdës, ke thënë nuk e di çfarë kërkojnë, por kërkojnë Gjilpërë në Kashtë. A bjemë dakord, kur themi po kur nuk ka, po pse Pojani nuk ka me shkollë të mesme?

Ornildi Demollari: Opozita në Gorë dhe Moglicë nuk ka sjellë fare kandidatura.

Yllson Ibrahimllari: Kryetarin e fshatit Velçan Gorë e ke Master Shkencor Infermieri, Z. Viktor Hoxhallari, nëse ti do ta dish pse unë nuk kam vendosur kandidatura rival në Gorë, e kam lënë që mos thonë që doktor Yllsoni po na përçan. Gora ka intelektualë.

Ornildi Demollari: Nuk po thojë këtë, sepse jam vetë nga Gora. Nuk po thojë këtë, po thojë që ju si opozitë kandidatët për zonën Gorë-Moglicë i keni sjellë me shumë vonesë.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Mund të them diçka? Ajo që tha Luli, varet në çfarë konteksti ka qenë, zakonisht jam i kujdesëshem në ato që them dhe veçanërisht me opozitën, në lidhje me Kryetarët e fshatrave, unë jo këtë herë, por në asnjë palë zgjedhje nuk jam marrë personalisht, sepse nuk kam dashur të jem pjesë e marrdhënieve apo grindjeve të asaj çfarë kërkon një fshat të zgjedhe edhe pse kjo është kompetencë e Këshillit Bashkiak, me ligj Këshilli Bashkiak ndjek procedurat nga larg si bëhet dhe bashkë me strukturat tona, bashkë me Sekretarin e Këshillit, Administratorët që të krijohet baza e nevojshme për tu bërë zgjedhjet. Sa është zbatuar rregullorja? Doktor Yllsoni ma vuri tani para këtë rregullore, me idënë a njoh apo jo.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Yllson Ibrahimllari: Jo ta vura në dispozicion për tju liruar nga disa punë, në këtë Këshill ka një problem është rritur pjaca e diskutimit, ka pjesmarje më të madhe, unë mendoj që grupi që unë drejtoj, ju kam thënë mos vimë më të papërgatitur se sa shkojmë e Parukieri në mbledhjet e Këshillave Bashkiak. Ne kemi mangësi në njohje, faleminderit Z.Çoçka që na bëri të mundur të njohim rregulloren.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Deri diku bie dakord me diskutimin e Lulit për efekt të zbatimit të rregullores, sa e mundur është të zbatohet ajo rregullore në kushtet aktuale në të gjithë bashkinë, kjo le vend për tu diskutuar dhe mos ka nevojë rregullorje të përmirësohet? Pyetje për Këshillin. Mund të jetë që të gjithë kandidatët të jenë me shkollë të mesme, por duhet të ketë një klauzolë atje ku nuk ka, do vendoset dhe dikush me arsim të ulët, që rregulloja thotë që duhet të zgjidhen anëtarët e kryesisë dhe ata zgjedhin Kryetarin e fshatit dhe këtu është e shkruar, nuk çfarë i heq, por a duhet të fillojmë një proces nga e para? Ju si Këshill duhet ta analizoni situatën edhe në total edhe rast pas rasti, nuk është kaq e thjeshtë marrin një vendim edhe krijojmë një amulli. Unë me sa di ju keni marrë një vendim për zgjedhjet e Kryetarve të fshatrave dhe ka mbritur konfirmimi i institucionit të Prefektit që shikon bazën ligjore të vendimeve, për mua rregullorja duhet parë, dëgjova që një anëtar pleqësie nuk mund të zgjidhet më shumë se 8 vjet, nuk e di ku e kanë bazuar! Sepse kjo është të shkelësh të drejtat e njeriut, çdo njeri ka të drejtë të zgjidhet të zgjedhë, e thotë Kushtetuta, këtë të drejtë ja heq vetëm votuesi. Kam bërë një konsultë me institucionin e Prefektit, pasi ka patur disa ankesa me zyrën Jurdike, ata kanë ardhur në bashki duke u bazuar në disa shqetësime nga grupe që kanë interes, ku midis tyre ishin dhe Podgoria, Zvezda dhe Drithasi dhe ai P-V që ju kam sjellë sot për Drithasin poshtë e kam sjellë duke u bazuar mbi një konsultë juridike me institucionin e Prefektit, ju mund të shprehni a është e drejtë, sepse Këshilli e ka kompetencë të merret me zgjedhjet, ne po ju sjellim një P-V si ekzekutiv në ndihmë Këshillit të bashkisë për ta hequr edhe këtë ngërç. Atje duhet të votojnë ata që kanë qendrën e votimit dhe Dithasi lart është i ndarë nga Drithasi poshtë dhe QV i kanë të ndara. Këshilli ka të drejtën dhe kemi gjetur një bazë ligjore të rrakorduar dhe me institucionin e Prefektit, që mos çonim një vendim dhe të na ktheheshe, duke hequr nocionin Kryetar fshati dhe do ketë kompetenca të njëjta dhe shpërblim si gjithë Kryetarët e fshatrave të tjerë, ky është nocioni i parë që po ju sjell. Në lidhje me shqetësimet e tjera, po ju them që institucioni i Prefektit ka kthyer zgjedhjet në Podgorie ka ardhur shkresa, ku thuhet se është shkelur rregullorja për arsimin, sespe atje ka ankesë, si duhet të veprojmë Këshilli? Këshilli duhet të marrë disa vendime që duhet të ecim në zbatim të ligjit, duhet të diskutohet rregullorja a është 100% e zbatueshme në gjithë territorin e bashkisë, sepse kjo rregullore është tip për të gjitha Këshillat për zgjedhjet e Strukturave Komunitare në fshat, por kjo nuk do të thotë që ju nuk duhet të bëni ndryshime që lehtësojnë situatën. Një moment tjetër duhet të vendosim çfarë duhet të bëjmë me këto të treja apo me të gjitha, por nuk është vendimarrje kaq e thjeshtë, ndaj dhe Kryesia e Këshillit duhet të mbledhet për diskutime edhe organi ekzekutiv është në mbështetje të Këshillit, jemi dy organe që duhet të bashkërendojmë punën në të mirë të komunitetit dhe Strukturat Komunitare në fshat janë shumë të rëndësishme, në këtë pikë jam i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

hapur për të diskutuar rast pas rasti çdo gjë dhe mbi bazën e dokumentave, po diskutuat emër për emër për çdo fshat nuk do e zgjidhim dot. Shumë faleminderit!

Lulëzim Hoxhaj: Dua të përshëndes orinetimin që ka dërguar Prefektura për fshatin Podgorie, që do të thotë që ai ka konstatuar që është shkelur rregullorja. Pyetja ime është. Në sa vende është shkelur rregullorja në zgjedhjet për Kryetar fshati? Le ta na i thotë Sekretari i Këshillit, Kryetari i Këshillit dikush që i ka ndjekur këto. Atje ku nuk ka me arsim jam dakord.

Pranvera Begolli: Duhet të kuptojmë diçka, jam dakord për ato që thotë Luli për arsimin, të gjithë Kryetarët e fshatrave që ne kemi votuar ne nuk mund ti kthejmë sepse thotë rregullorja për arsimin e kemi votuar në mënyrë kolegjiale të dyja palët, ka shkuar në Prefekturë dhe janë miratuar.

Lulëzim Hoxhaj: Në mënyrë kolegjia është votuar dhe rregullorja në vitin 2020.

Yllson Ibrahimllari: Kam vërejtje për drejtimin e seancës, unë jam krejtari i grupit më të madh të opozitës, kam minutaszh në dispozicion, do shpjegoj arsyet pse nuk kam qenë prezent në mbledhjet kaluara.

Lulëzim Hoxhaj: Po të pyes tani, ne sa vende është shkelur rregullorja ju nuk keni informacionin, sepse nuk janë organizuar zgjedhje për Kryetar fshati, nuk keni proceverablet ende, ja kërkova këtë Sekretarit të Këshillit me tha nuk na i kanë sjellë akoma.

Rudina Bregu: Lulëzimi më përmendi gjatë gjithë kohës dhe po bie ndesh me ato që po thotë, doktori mund të më korigjojë nëse e kam gabim sepse kemi qenë të dy në zonën e Gorës, nuk mund të thuash që nuk u bë procesi. Dua të të bëj një pyetje në sa procese për zgjedhjen e Kryetareve të fshatrave ka marrë pjesë?

Lulëzim Hoxhaj: Në asnjë.

Rudina Bregu: Po atëherë si mund të dalësh në përfundim që janë shkelur të gjitha procedurat për zgjedhjet për Kryetar fshati, ku unë me doktorin kemi qenë në Gorë preznet dhe kandidati i juaj nuk u paraqit as të votonte për veten e tij, të gjitha procedurat janë bërë në rregull, nga procevrebalet dhe i gjithë procesi, ky ishte një rast. Nuk mund të hedhesh poshtë një proces të gjithë kur nuk ke qenë vetë prezent.

Lulëzim Hoxhaj: Në Zvezdë ke qenë?

Rudina Bregu: Jo kam qenë prezent në atë zona ku isha caktuar. Për Kryetarët fshatrave kush na siguron që diksuh që ka arsimin përkatës të jetë më i përgjegjshëm dhe më i aftë se dikush që nuk e ka? Nuk duhet parë arsimi kur komuniteti i voton. Në Drithas poshtë ai që sot është kandidati juaj sot, më parë donte të kandidonte për ne dhe unë nuk kam asnjë kundërshtim le të kandidojë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pranvera Begolli: Si kryetare e Komisionit të Ligjeve, mund ti pezullojmë këto diskutime? Dhe të japim rezultatet.

Aleksandra Spaho: Do e nisim me Zvezdën, jam marrë presonalisht, kam bërë ankesë në Prefekturë dhe përgjigjija më ka ardhur zyrtarisht dhe nga Jursiti i Prefekturës, ku më ka thënë: Në Zvezdë duhet të bëhen votime, ashtu si i do fshati. Shkresat janë që në datë 12 tetor 2023. Sot kemi një vendim të datë 18.12.2023 ku thotë për fshatin Zvezdë sillini një propozim konkret dhe ky propozim konkret si Aleksandra që kam qenë e pranishme në atë fshat me proceverable etj, jo se kam ndonjë emër konkret por thjeshtë për procesin. Në datën 26.12.2023 kolegija ime Rudina, ku propozimi ime ka qenë të bëhet dëgjese publike në fshat, për mënyrën si do zhvillohen zgjedhjet të vendosi fshati dhe kam dhe një emër si subjekt. Kolegija ime Rudina thotë atje janë bërë zgjedhjet, ku më lexon dhe një proceverbal, atë që lexon binte shumë ndesh dhe linte shumë për të dëshiruar se thotë kandidati juaj ka hequr dorë, por ishin gjashtë të tjerë llogjikisht në çdo lagje, nuk kishte Zvezda asnjë emër tjetër përveç atij që dha dorëhqjen!? Kemi dhe një proceverbal ku ka emra dhe firma, por kam dhe unë një proceverbal me 150 firma, ku thuhet që në fshatin Zvezdë nuk janë zhvilluar zgjedhje fare, e mbylla, tani vendimi i takon Këshillit, unë i qëndroj atyre që kam thënë dhe në Prefekturë, mua më intreson që fshati Zvezdë mos ndahet nga të gjithë fshatrat e tjerë, të lejohen të bëhen zgjedhje, pastaj le ta fitojë ai që është më i miri, atë e vendos fshati. Në lidhje me Podgorien edhe me procesin, ne të gjithë pak a shumë e kemi firmosur proceverbalin, Kryetari i Bashkisë me të drejtë mund të thotë dhe këtu duhet të ndërhy unë! Në Nj. A Pirg kam qenë unë Kryetare e Komisionit të Mbikqyres dhe i kam thënë të gjitha çfarë ka patur gjatë procesit, i kemi miratuar emër për emër dhe ka ardhur konfirmimi i Prefektit dhe sot kojtohemi për kriterin e arsimit dhe në Podgorie kam prezent bashkë me Almirin nga ora 8:00-16:00 dhe gjatë procesit të numurimit nuk pati asnjë problem dhe nuk kishte asnjë kundërshtim dhe paregullësi, kanë nënshkruar pesë Këshilltarë dhe Komisioni i votimit në Podgorie.

Yllson Ibrahimllari: Të nderuar Këshilltarë! Ju jam derejtuar me deklaratë në datën 18.12.2023 dhe ku kemi thënë, ne si grup opozitar do bojktojmë mbledhjet e Këshillit Bashkiak deri në zgjedhjen e problematikave për zgjedhjen e Kryetrave të fshatrave Zvezdë dhe Drithas poshtë, ky ka qenë qëndrim politik dhe në unison me të gjithë anëtarët e grupit që unë përfaqësoj. Ndodhemi përballë një fakti që kërkoj mirëkuptim politik të të dy grupeve dhe po kërkoj vullnet të Kryetarit ose së paku lënë të lirë të Këshillit në marrjen e një vendimi. Tani na hapet problemi i Podgories, Velçani i Gorës etj, jemi përballë një fakti, në mbledhjen e datës 31.10.2023, Nën/Kryetari i Këshilli Z.Faslli ju ka kërkuar diçka, ne skemi rregullore, ne skemi bërë shumë çka nga rregullorja, por ju të gjithë e kundërshtuat, ne kemi rregullore por nuk e njeh ti Z.Faslli. Doni ti miratojmë zgjedhjet në Zvezdë? Po ju them Kryetari është i ligjshëm, por nuk është i ligjshëm në rregullore, rregullorja nuk ja u lejon të zgjedhni Kryetarin e Zvezdës, këtë rregullore do ju u interpretojë Prefketa dhe do ju kthejë ashtu si ju ka kthyer Podgorien. Kemi ne vullneti, që të marrim një vendim ta rishikojmë këtë rregullore dhe rregulloren e Këshillit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkiak, sepse Këshilli Bashkiak i Tiranës e ka rregulloren me 67 nene, ne kemi 197 nene aq sa ka e gjithë OKB.Dua tju them ku është e bazuar në ligj zgjedhja në Zvezdë dhe ku është anti ligjore nëse shkojmë në procedurë? Unë nuk kam asnjë interes në Zvezdë, jemi përballë një fakti që dikush ka fotografuar dhe dikush i ka marrë firmën dhe dikush e ka sjellë.Zotëria ka qenë jashtë vendit në datën 17 dhe është kthyer në datë 24 dhe na paske dhënë dorëheqjen në datë 30!Me një fletë që nuk e ka, më fal ku e ndalon ligji?Sa ditë para duhet të japë dorëheqjen? Kemi ne një Komisioni për Administrimi të Zgjedhjeve? sipas nenit 39 të rregullores, që je kemi miratuar në datë 26.06.2020 me nr.46, Komisioni i qendrës të votimi, përgatitja e Kryerisë së Këshillit etj.Kryetari i Bashkisë e ka vendosur organigramën e tij në funksion të Këshillit, ky Këshill ka treguar paaftësi në të vetme zgjedhje që zhvillohen njëherë në 4-vjet.A ka një vullnet politik? Po i kemi miratuar bashkë dhe atje ku ka patur problematika, atje ku ka problematika, kemi ndërtuar Struktura Komunitare shumë delikate sepse janë zgjedhur jashtë rregullores.Do marrim një vullnet politik, që të gjithë këta janë të miratuar?Apo do hapim votimin në Zvezdë ashtu si e hapëm në Drithas, kalojmë në krahun tjetër i quajmë të rregullta, por do shohim se pas dy muajsh që Gjykta Administrative do përsëritë zgjedhjet, po e futim Këshillin në një ngërç të pa nevojshëm po ashtu dhe Kryetarin që përveç detyrave ligjore që ka vetë, duhet të dëgjojë dhe këto debate.Zotërinj zgjedhjet që kemi organizuar janë në kundërshtim me këtë rregullore, nuk kemi ndjekur procedurat, me procedurë kthehen pas, kemi një ankesë për Zvezdën, dikush e fotografon, bashkëshorti i një anëtarë që mbikqyr procesin e fotografon, në datë 15 Dhjetor deri në orët e vona nuk na është thënë që janë zhvilluar zgjedhjet në Zvezdë, prisnit deri sa ta protokollonit, Kryetarit i ka shkuar shkresa e ka sigluar dhe ja ka dërguar Këshillit.Për mua zgjedhjet në Zvezdë janë të parregullta, janë në kundërshtim me rregulloren miratuar me vendim nr.46 date 26.06.2020, kur të kemi një rregullore tjetër hajde ti diskutojmë.Kemi folur për procedurë dhe kemi thënë, që këto zgjedhje do zhvillohen ashtu si në vitin 2019, shumë mirë kemi bërë, por problemi është që kjo rregullore nuk na lejon të bëhen zgjedhjet ashtu si në vitin 2019, pasi kemi një rregullore në fuqi.Kur i marrim copy-paste nga organizma që paguhen nga fondet e shtetit apo nga donatorët, i miratojmë me shpejtësi ato rregullore dhe pastaj i ngtarojmë.Në respekt maksimal të Kryetarit, sepse na ka mundur të gjithëve me vota, është njeriu i natës dhe ditës, miku më i madh i tij jam unë nga ju.Nëse doni votojeni Zvezdën dhe do shikoni kur tju kthehet pas dy muajsh.Faleminderit!

Pranvera Begolli:Kryetar! fjala ishte për Komisionin e Ligjeve, vajzat janë atje, Petriti dhe Rudina.Unë po them diçka, thuhet pse nuk u njoftua Këshilltarja e opozitës për zgjedhjet, që zotëria kishte dhënë dorëheqjen.Dorëheqja ishte protokolluar në datë 31 pranë bashkisë dhe i është paraqitur Këshillit.Personi nuk ka pse merr pëlqimin e dikujt për dorëheqjen, ky është një vendim personal, përderi sa ai dha dorëheqjen dhe nuk kishte kandidat tjetër dhe zgjedhjet u zhvilluan.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në zyrat e bashkisë ka një procesverbal që ka ardhur për Zvezdën, mbi këtë duhet të punojmë që mban datën 02.12.2023, qëndron apo nuk qëndron e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

vendos Këshilli.Ky është firmosur nga anëtarët e Komisionit të QV, ka një procesverbal po i datës 02.12.2023, që nuk ka patur ankesa dhe ka marrë 81 vota, ka një deklaratë në bashki për dhënie dorëheqje nga z.Soklol Xhuti me shkrim dhe i firmosur, ka dhe listën me emrat që kanë votuar dhe firmosur.Ka dhe një procesverbal, që ky është më i rëndësishmi, të firmosur nga katër Këshiltarë, Fevri Sherfi, Danjela Ibrahim, Rovena Terolli, Andonaq Risto.Kjo është lidhja që është bashki.

Faslli Zholi:Kam një pyetje Kryetar? Atje ku janë bërë zgjedhjet, ne i kemi pranuar.Unë punoj me shkresa, ja ku është dhe Sekretari i Këshillit, i kam të gjitha në dosje korespondencat.Pse ndahet Drithasi me Zvezdën? Ne nuk ka intreson kush është personi, të gjithë këtë problematikë e keni sjellë ju si mazhorancë, pse?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ne mund të sillnim dhe një P-V për Zvezdën dhe e kishim miratuar tani.

Faslli Zholi:Ju vërtet i keni numrat dhe e miratonit, por unë flas për cilësi, jo për sasi.Kjo do të thotë mos shkelim rregullat dhe ligjet.Pse nuk na njoftuat që kandidati juaj është tërhqeur? Por bëni zgjedhje ditën e nesërme.

Ornildi Demollari:Të gjitha këto i trajtoj Kryetari i grupit Faslli.

Faslli Zholi:Unë mendoj të bëhen zgjedhjet dhe në Drtihas dhe Zvezdë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ju lutem kam angazhime të tjera, nëse keni pyetje për mua?Ajo që do ju kërkoja që P-V, nëse nuk është banor prej pesë vitesh nuk mund të jetë kandidat.

Petrit Kupe:Për deri sa bëhet fjalë për Dirthasin, më vjen njëkohësisht mirë dhe keq, unë ja u kam thënë që në fillim si duhet bërëm ne nuk ishim të aftë ta gjykonim drejt, shkuam deri atje sa po thoshim që nuk është fshat, që ai është fshat i krijuar në 25 Janar 1950.Arsyje që u zgjat ishte që dikush deshë të kandidojë, por e vlersoj Kryetarin për kompetencën tonë solli këtë P-V dhe për më tepër e la të zgjidhet në mënyrë demokratike, spese propozimi ishte të vendoseshe dikush i emëruar, që në gjykimin tim ishte i gabuar, Kryetari i zgjedhur do ketë kompetenca të njëjta si të tjerët, tani kjo morri zgjidhje, kjo situatë prej më shumë se katër muajsh që neglizhoheshë nha Këshilli, pas përfundimit të zgjedhjeve të tjera.Unë e gjykoj edhe pse jam përfaqësues i PS, që zgjedhjet në Zvezdë janë bërë të nxituara dhe të njëanshme , prandaj them që të miratojmë P-V e Drtihasit dhe Zvezdës pasataj.Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari:Nëse zgjedhjet në Drtihas do bëhen sipas rregullores, do zbatojmë rregulloren, nga ditët e shpalluara, njoftimet e bëra publike, me anëtarë pleqëse, pjesmartje, 60 ditë, të drejtën për tu tërhequr kandidati e ka 25 ditë pra zgjedhjeve e ka rregullorja.Të kthejmë zgjedhjet në Zvezdë dhe të bëhen te shkolla.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Para se të kalojmë në votim Drithasin, do doja nga Këshilli një mendim për Zvezdën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë mund të sillja dhe një P-V për Zvezdën, ose për zgjedhje të reja edhe pse është kompetenca juaj, ose të miratonim dokumentacionin që kemi, ndaj kam sjellë vetëm Drithasin.

Ornildi Demollari:Ju lutem e kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 26 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet pika 11 e rendit të ditës, 26 vota pro, Faleminderit!Idlir Limllari dhe Armando Dautllari, janë larguar nga mbledhja.

Lulëzim Hoxhaj:Unë propozoj të jetë e ndarëme lagje dhe që mos quhet Kujdestar fshati, por Kryetar fshati dhe të ketë kompetenca të njëjta.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Që të quhet lagje duhet të ketë një popullësi 20 mijë banorë, atë emërtim e kam konsultuar me Institucionin e Prefektit, nuk e kam venë nga vetja ime, erdhën Jursitet dhe ju thashë më gjeni një zgjidhje për një fshat që ka 300 banorë dhe ata ma dhanë kët zgjidhje, por ka kompetenca të njëjta.

Lulëzim Hoxhaj:Kam edhe diçka, a lejohet Dashnor Shahinasi të kandidojë? Lejën e banimit e ka në Drithas prej shumë kohësh.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Duhet ta ketë dhe QV atje ku kandidon.

Lulëzim Hoxhaj:Ju e keni presonale me D.Shahinasin, ai para 1 muaji jeton te vjerri dhe vjerra poshtë dhe kam 150 firma këtu.

Ornildi Demollari:Kujestari duhet të jetë banor i Drithasit poshtë.Jemi te diskutime të ndryshme, të dëgjomë një qytetare, ka nevojë për ndihmë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të çojë kërkesë te zyra përkatse dhe do shohim si mund ta ndihmojmë.

Ornildi Demollari:E miratojmë në parim ndihmën?

Kush është dakord ? 26 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet me 26 vota pro, Faleminderit!

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kjo ishte mbledhja për sot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

